



## Asociacioni i Komunave të Kosovës

---

### Report nga Takimi i Kolegjiunit të Zyrtarëve Ligjor të Komunave të Republikës së Kosovës

---

**Për:** Shefat/Zyrtarët Ligjor të Komunave  
**Nga:** Shqipe Arifaj – Zyrtare Ligjor e AKK-së  
**Kopje:** z.Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së  
**Data :** 27 shtator 2011  
**Subjekti :** Raporti i takimit të pestë të Kolegjiunit të Zyrtarëve Ligjor

---



27 shtator 2011, Salla e Kuvendit Komunal Shtërpce

---

Rruga "Gustav Mayer" nr.5, te.038/245-732;245-734;245-735 fax.038-245-733

[www.komunat-ks.net](http://www.komunat-ks.net)

Page 1

## HYRJE

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) organizoi takimin e tretë të Kolegjiut të Zyrtarëve Ligjor të Komunave të Republikës së Kosovës të AKK-së, për vitin 2011 në Komunën e Shtërpces.

Sipas planit të punës për vitin 2011, dhe çështjeve të cilat janë aktuale u caktua takimi për të diskutuar ligjet të cilat janë në procedurë të plotësim-ndryshimit.

Në këtë takim morën pjesë zyrtarët ligjor të komunave, Besim Murtezani Udheheqës i Divizionit dhe Edona Gashi zyrtare ligjore në Departamentin Ligjor të MAPL-së, Driton Vatovci Koordinator i projektit nga GIZ-i, Selvete Dibrani- këshilltare ligjore nga Projekti DEMI-USAID, Bilbil Kastrati-zyrtar ligjor nga Departamenti i Pronës në OSBE-Prishtinë, përfaqësueset e OCBE-së për legjislacion dega Pejë, zyrtarët komunae nga komunat e reja dhe zyrtarja ligjore e AKK-se znj. Shqipe Arifaj.

## PËRMBLEDHJE

Takimin e hapi dhe kryesoi kryesuesi i KZL-së **z. Agim Salihu**, i cili i përshëndeti të pranishmit, falenderoi përfaqësuesit e institucioneve organizatave tjera që e mbështesin AKK-në, kryetarin e komunës së Shtërpces **z. Bratislav Nikoliq**, për pjesmarrje të cilit ia dha fjalën për ta përshëndetur Kolegjiutin e Zyrtarëve Ligjor.

**Kryetari i Komunës së Shtërpces z. Bratislav Nikoliq** –ju dëshiroj mirëseardhje në Komunën e Shtërpces, kolegjiuti i zyrtarëve ligjor, është një kolegjiut profesional dhe bënë punë shumë profesionale, me çka unë ju uroj një ditë të suksesshme në Komunën tonë.

**znj. Shqipe Arifaj** – së pari falenderoi kryetarin e Komunës i cili na përshëndeti në këtë takim, të gjithë zyrtarët ligjor të komunave, pjesmarrësit tjerë nga MAPL-ja, GIZ-i, DEMI, OSBE-ja e cila më pastaj tha se, ky kolegjiut është vlersuar si shumë i dobishëm për arsye të punës së madhe që kanë këta zyrtar nëpër komuna, dhe ceku arsyet pse nuk është mbajtur takimi i tretë në muajin qershor, për arsye se AKK-ja kishte 10 vjetorin e themelimit, andaj kishte shumë aktivitete gjatë atij muaji. Po ashtu ceku se ky takim ka në diskutim ligjet që janë shumë të rëndësishme për komunat dhe kontributi i Juaj është më se i mirëseardhur për të dhënë rekomandime. Në fund iu dëshiroi suksese në këtë takim të kolegjiutit.

**Kryesuesi-** prezntoi rendin e ditës :

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit nga takimi i dytë në Prizren;
2. Shqyrtimi i ligjeve:
  - a. Zbatimi i Ligjit për Shfrytzimin e Pronës Komunale;
  - b. Zbatimi i Ligjit për Ndërmarrjet Publike;
  - c. Zbatimi i Ligjit për Pyjet;
3. Takimi i Kryesuesit të KZL-së me zyrtarët e MAPL-së;
4. Aktuale ( Ligjet dhe aktet nënligjore që janë nxjerrur gjatë vitit 2011);
5. Të ndryshme

**Pika e parë:** Shqyrtimi i raportit nga takimi i dytë në Prizren

---

Rruga "Gustav Mayer" nr.5, te.038/245-732;245-734;245-735 fax.038-245-733

**U miratua, pa asnjë vërejtje.**

**Pika e dytë: Shqyrtimi i ligjeve**

**a) Ligji për shfrytëzimin e Pronës Komunale ;**

**Kryesuesi** - Qëllimi është zbatimi dhe aplikimi i këtij ligji, ju e dini që më herët ka qenë rregullorja 2007/30, tani në LVL është neni 14 dhe Ligji i ri për këtë çështje. Dhënia e pronës për 10 vite ju është lënë kuvendeve komunale, kurse për 40 vite është lënë nivelit qendror.

Rreth praktikave në komuna diskutuan zyrtarët ligjor të komunave **z.Avni Bytyqi- Suharekë, z.Ali Shala-Klinë, z.Hevzi Matoshi-Gjilan, z.Avni Hoda- Kamenicë, z.Visar Islami- Prizren, z.Isa Hyseni-Mitrovicë**. Këta zyrtar paraqiten shqetsimet e tyre që po iu paraqiten gjatë kryerjes së punëve rreth kësaj qështjeje. Ata kërkuan që Ligji ka disa pengesa andaj si i tillë nuk mund të gjej zbatim, por duhet të filloj procedura e plotësim-ndryshimit .

**z.Besim Myrtezani**- Udhëheqës i Divizionit në Departamentin Ligjor në MAPL - mendoj se duhet të ngriten të gjitha shqetësimet e legjislacionit dhe se ne nga pozicioni i Ministrisë e dimë se ky ligj ndikon drejtpërdrejt në Komuna. Mendoj që debati duhet të shtrohet në vështirësimin e tyre në Komuna. Nëse bëhet këmbimi i pronës duhet të përcillen të gjitha procedurat për shfrytëzimin e pronës komunale. Shpesh kemi shkresa edhe në Ministri që prona komunale jepet edhe pa kritere. Prona nuk mund te jepet pa bazë dhe me një kërkesë të një qytetari, ajo duhet të shkohet përmes konkurrencës së lirë.

**Kryesuesi** - Pasi nuk kemi kohë shumë dhe diskutime, më këto shqetësime do ti drejtohem me shkrësë MAPL-së në mënyrë që të amandamentohet ky Ligj.

**b) Ligji për Ndërmarrjet Publike;**

**Kryesuesi** - unë kam shumë vërejtje, duke filluar nga nenet 1, 3, 5, 11, 15 dhe listat që janë paraparë për ndërmarrjet. P. Sh. Neni 3 ish ndërmarrjet që kanë qenë nën ombrellën e AKP-së të trajtohet si ndërmarrje e qeverisë. Neni 1 komisioni i aksionarëve mos të ekzistoj por të jetë bordi nga komuna. Këto do ti japim si propozime për ndryshim. Komisioni i aksionarëve ka punuar në baza vullnetre, duhet fuqizohet roli i këtij komisioni.

Diskutuan zyrtarët ligjor **z.Faruk Guri- Shtërpce, z.Ali Shala- Klinë, z.Hevzi Matoshi-Gjilan, z.Isa Hyseni-Mitrovicë, z.Flamur Vula-Gjakovë**, të cilët- thanë se është shumë mirë që po bëhet ndryshimi i këtij Ligji. Ka pasur mangësi në pikëpamje ligjore, kur është kërkuar përgjegjësia nuk është ditur se nga të kërkohet, nëse e merr Ligjin e LVL-së shifet që shërbimet janë në kompetencë të Komunës. Ne kemi reaguar ndaj asaj që mos të jetë në AKP. Tani në momentin e fundit jemi duke e parë se kemi mjaft probleme dhe defekte nëpër komuna, disa nga ndërmarrjet e parapara në këtë ligj nuk kanë status, pastaj kemi vërejtje te komisioni i aksionarëve.

**c) Ligji per Pyjet ;**

**Kryesuesi** – Siq e dim ne vitin 2010, iu bart një pjesë e kompetencave komunave , mbrojtja kaloi tek komunat, por komunat nuk ishin aq te përgaditura dhe nuk u rregullua kjo çështje me dokumentacion as nuk u be pranim dorëzimi me shkrim, me u evidentua situata, me u dit se në qfar gjendje po e marrin komunat gjendjen e pyjeve dhe pastaj me u be krahasimi se a ka përmirsim. Përsëri mund të themi se mbrojtja e pyjeve në komuna shihet qartë se është shumë me mirë siç ka qenë më herët.Me qenëse zyrtarja ligjore e AKK-së është në rrjedha, po ia japim fjalën të na informoj lidhur me ligjin në fjalë.

**znj.Shqipe Arifaj** – Unë po iu informoj se AKK-ja është anëtar në grupin punues për hartimin e Ligjit për Pyje, në të cilin grup kam marrë pjesë une, ku i kam paraqitur shqetsimet e komunave, dhe kam mbrojtur qëndrimin e komunave, për kompletim të kompetencave, rritje të stafit dhe ngritje të përqindjes të mjeteve buxhetore të cilat deri tani kanë qenë 70 % për nivelin qendror dhe 30 % për nivelin lokal, ne kemi propozuar 50 me 50, besojmë se kjo do të pranohet. Po ashtu jemi në takime të rregullta me përfaqësuesit ndërkombëtar të projektin të binjakëzimit projekt i BE-së për përkrahje MPBZHR për fushën e pylltarisë, ky aty ne po kërkojmë ndarje të kopmpetencave të qarta mes institucioneve.

Diskutuan zyrtarët ligjor **z.Ali Shala-Klinë, z.Ismet Kukleci-Junik,znj.Fitore Daci-Kaqanik**, të cilët ceken qështjet rreth definimit të pyjeve dhe tokave pyjore, inspeksionit i cili duhet te jetë lokal, për ndaljet e procedura të privatizimit të ekonomive pyjore etj.

#### **Pika e tretë : Takimi i Kryesuesit të KZL-së me zyrtarët e MAPL-së**

**Kryesuesi**- kam pasur disa takime me zyrtarët e MAPL-së, kam marrë pjesë në Konefenrencën e dytë ndërkombëtare për pushtet lokal, kam pasur takim me drejtorin e Departamentit Ligjor z.Agron Maxhuni, dhe me zyrtar tjerë, bashkëpunimi është në nivelin e duhur.

#### **Pika e katërt: Aktuale ( Ligjet dhe aktet nënligjore që janë nxjerrur gjatë vitit 2011);**

**Kryesuesi** - ne kemi parë edhe në Web Faqet zyrtare Ligjet që janë nxjerrë dhe kemi edhe fletoret zyrtare, p.sh kemi ligjin mbi tregtinë e brendshme, shoqëritë tregtare, etj, që prekin edhe interesat e pushteteve lokale. Pastaj mosmiratimi i rregullores për pagat e shërbyesve civil është shumë shqetësues për neve për shkak edhe të mos gradimit shërbyesve civil. Ndryshimi i statuteve për zyrat për komunitete, qëndren për shërbime të qytetarëve, zyrën për të drejtat e njeriut, e të tjera.

Diskutuan zyrtarët ligjor , **z.Matoshi-Gjilan, z.Shala-Klinë, z.Hoda-Kamenicë,znj.Daci-Viti, z.Vula-Gjakovë**, etj rreth Ligjit mbi tregtinë e brendshme, ndërmarrjet tregtare, kushtet teknike minimale, çdo ndërmarrje që ka një çështje të shërbimit, pastaj inspektorët komunal të dalin në ministrinë përkatëse. Ministria e Tregtisë nuk ka marrë asnjë hap në këtë drejtim deri tani. Gjithashtu edhe inspektorët sanitar që veprojnë në komuna ata punojnë kurse llogariten si punëtorë të Ministrisë.

Te leja e punës, lidhen edhe tarifat me ligjin e financave të pushtetit lokal thuhet që të jepet një tarifë, si biznes që punon në komunë, çka do të thotë që nuk janë të harmonizuara ligjet mes vete. Edhe ligji për menaxhimin financave dhe përgjegjësive është hequr që të bëhet përfaqësimi në gjykata, ne në bisedë

me Ministrinë e Drejtësisë kemi hasur në paqartësi që edhe ata se kanë këtë të qartë. Është e nevojshme që një dispozitë e tillë të rikthehet.

### **Pika e pestë: Të ndryshme**

**z.Bilbil Kastrati- zyrtar ligjor në OSBE** - Unë po iu informoj se ne vazhdimisht kemi përkrahur zyrtarët komunal në fushën e pronës , po ashtu kjo përkrahje do të avzhdoj edhe në të ardhmen, për vitin 2012 do të filloj projekti për mbajtjen e trajnimeve për zyrtarët ligjor, për shfrytëzimin e pronës komunale, i cili trajnim do t'ju ndohmoj mjaft shumë në kryerjen e punëve të përditshme.

**Kryesuesi** – Në fund iu përshëndes të gjithëve për pjesmarrje dhe takimin tjetër do ta mbajmë sipas planit të punës.

### **REKOMANDIME :**

- ❖ **Do ti drejtohem me shkresë MAPL-së në mënyrë që të Amandamentohet Ligji për shfrytëzimin e pronës komunale ;**
- ❖ **Nevoja e organizimit të trajnimeve për zyrtarët ligjor për shfrytëzimin e pronës komunale;**
- ❖ **Përkrahen rekomandimet propozim-amandamentet që AKK-ja i ka paraqitur për LNP-në si dhe plotësohet amandamenti për listën 2 arsyetohet me Vendim të Kryeministrit z.Agim Çeku se prona e Stacioneve të Autobusëve duhet të menaxhohet nga komunat;**
- ❖ **Proejkt Ligji për pyjet pritë të miratohet më shpejtë për t'i qartësuar kompetencat e komunave si dhe për ndonjë propozim apo rekomandim zyrtarët ligjor i përcjellim me shkrim;**